



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1355/1 Prot.

Durrës më, 31/08/2023

V E N D I M

Nr. 50 Datë 31/08 2023

PËR

**"MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË NË "E DREJTË PUBLIKE", DIPLOMË E DYFISHTË ME UNIVERSITETIN E ROMËS "TOR VERGATA" DHE UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE PRANË DEPARTAMENTIT TË DREJTËSISË".**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë", Udhëzim Nr. 20 datë 30.09.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020", i ndryshuar, Udhëzim Nr.25, datë 28.12.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor", ndryshuar me VKM Nr. 808, datë 11.12.2019, Rregullores dhe Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Senati Akademik,

**V E N D O S I:**

1. Për miratimin e Rregullores së programit të ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë në "E Drejtë Publike", diplomë e dyfishtë me Universitetin e Romës "Tor Vergata" dhe Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, pranë Departamentit të Drejtësisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Zv. Rektorët
  - Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit
  - Drejtuesi i Njesisë Bazë

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela **SOTIROFSKI**

